

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Filologjisë // Departamenti i Letërsisë Shqipe
<b>Titulli i lëndës:</b>	Letërsi e krahasuar
<b>Niveli:</b>	Master // Obligative
<b>Viti i studimeve:</b>	I pestë (semestri IX)
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2 + 1
<b>Koha, lokacioni, detajet kont.:</b>	E hënë 10 – 12 // Salla 78 // Email. <a href="mailto:osman.gashi@uni-pr.edu">osman.gashi@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p><i>Kursi i Letërsisë së krahasuar është paraparë që t'i përgatisë studentët e Departamentit të Letërsisë Shqipe që kanë kryer studimet e shkallës Bachelor, për punë hulumtuese – shkencore në një fushë specifike të studimeve letrare. Do të shpjegojë konceptet dhe zhvillimet teorike, të cilat zbatohen përmes vizioneve fleksibile mbi funksionet e teksteve letrare si dhe të mesazheve letrare artistike.</i></p> <p><i>Metodologjia letrare krahasimtare ofron njohuri specifike të metodologjisë letrare, për instrumentet dhe nocionet teoriko – letrare siç janë: influencat, interaksionet letrare, relacionet, plagjiarizmi, burimet e letërsisë, gjeneza e zhanreve letrare, intertekstualiteti, përkthimet, receptimi, lexuesi dhe të lexuarit, kontaktet letrare etj.</i></p> <p><i>Të gjithë këta konstituentë të Letërsisë së krahasuar do të shtrohen në një proces interaktiv dhe praktik (përmes ligjëratave si dhe hulumtimeve që bëjnë vetë studentët), ku do të përfshihen shembuj të letërsive të veçanta dhe përfaqësuesit kryesorë të tyre.</i></p> <p><i>Ky modul i konceptualizon nocionet, idetë dhe definicionet siç janë: Letërsi botërore dhe Letërsi nacionale si dhe interaksionet midis tyre, nga njëra anë dhe vlerat universale letrare të të gjitha kohëve, nga ana tjetër.</i></p> <p><i>Studimi i letërsisë së krahasuar është ngushtë i lidhur edhe me hulumtimet interdisiplinare për fushat tjera të dijes si: filmi, muzika, teatri etj.</i></p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p><i>Qëllimi themelor i kursit është që të njohë studentët me konceptet dhe postulatet themelore të disiplinës së Komparatistikës si dhe me zhvillimet aktuale të saj te ne dhe në botë. Gjithashtu do të bëhet përpjekje që studentët individualisht apo në grupe të hulumtojnë vetë dukuri, vepra e autorë të letërsisë shqipe e botërore në kontekstin krahasimtar.</i></p>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p><i>Gjatë zhvillimit të ligjëratave, ushtrimeve e konsultimeve si dhe në përfundim të kursit studentët do të kenë mundësinë:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><i>Të fitojnë informacione dhe të demonstrojnë njohuri për letërsinë e shkruar në vende të ndryshme e në periudha të ndryshme historiko – letrare;</i></li> <li><i>Të tregojnë aftësi për lexime kritike si dhe për shkrime kritike – analitike e krahasimtare;</i></li> <li><i>Të përdorin me saktësi literaturën shkencore teoriko – letrare e historiko – letrare</i></li> </ol>
<b>Metodologjia e</b>	

<b>mësimëdhënies:</b>	<i>Ligjërata, ushtrime kollokuiume, teste, punë në grupe, shkrime esesh</i>
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<i>Vlerësimi i parë: 15 % / Vlerësimi i dytë 15 % Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 30 % Vijimi i rregullt 10 % Provimi final 30%</i>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<i>Homeri: Iliada – Gj. Fishta: Lahuta e Malcis; Eskili: Orestia – Shekspiri: Hamleti; Dante Aligieri: Komedia hyjnore – Servantesi: Don Kishoti i Mançës; Stendal: E kuqja dhe e zeza – Tolstoj: Ana Karenina; De Rada: Këngët e Milosaos – Pushkini: Eugjen Oniegin; Homer: Odiseja - Xh. Xhojs: Uliksi; E Heminguej: Për kë bien kambanat – P. Marko: Hasta la Vista; F. Kafka: Kështjella – Xh. Orvel: 1984</i>
<b>Literatura shtesë:</b>	<i>Yves Chevrel: <b>Letërsi e krahasuar</b>, Tiranë 2002; Rene Velek e Ostin Uoren: <b>Teoria e letërsisë</b>; Northrop Fraj: Anatomia e kritikës; Osman Gashi: <i>Studime interliterare</i>, Prishtinë 2001; <b>Letërsia dhe Miti</b>, Prishtinë, 2014; <i>Kufijtë e letërsisë</i>, Prishtinë, 2008; Eliot, Thomas Sterns: <b>Ese të zgjedhura</b>, Prishtinë, 1982; Croce, Benedetto: <i>Poezia antike dhe moderne</i>, Tiranë, 1998; Lodge, David: <i>20th Century Literary Criticism</i>, London &amp; New York, 1994; Claudio Guillen: “<i>The Challenge of Comparative literature</i>”, Harvard University Press, 1993; Nathalie Piegay – Gros: <b>Poetika e intertekstualitetit</b>, Prishtinë...; Fromm, Erich: <i>Gjuha e harruar</i>, Tiranë, 1998</i>
<b>Plani i dizajnuar i mësim:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	<i>Letërsia kombëtare, Letërsia botërore dhe Letërsia e përgjithshme</i>
<i>Java e dytë:</i>	<i>Letërsia e krahasuar – postulatet themelore, bazat teorike dhe historia</i>
<i>Java e tretë:</i>	<i>Folklori dhe mitologjia</i>
<i>Java e katërt:</i>	<i>Letërsia perëndimore deri në Renesancë</i>
<i>Java e pestë:</i>	<i>Letërsia perëndimore pas Renesancës</i>
<i>Java e gjashtë:</i>	<i>Morfologjia letrare (gjinitë, zhanret e format letrare – perspektiva globale)</i>
<i>Java e shtatë:</i>	<i>Periodizimi ndërkombëtar i letërsisë – periudhat letrare; brezat (gjeneratat)</i>
<i>Java e tetë:</i>	<i>Idetë letrare (vështrim i përgjithshëm)</i>
<i>Java e nëntë:</i>	<i>Idetë religjioze dhe idetë filozofike</i>
<i>Java e dhjetë:</i>	<i>Idetë shkencore dhe idetë politike</i>
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<i>Ndërmjetësit letrarë – përkthyesit dhe përkthimet letrare</i>
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<i>Shkëmbimet letrare ndërkombëtare</i>
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<i>Rrafshet e interliteraritetit (vështrim i përgjithshëm)</i>
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	<i>Reminishencat, huazimet letrare dhe ndikimet</i>
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<i>Kongruencat, Filiacioni, lidhjet etnike, regionale, gjuhësore</i>